



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 220 I Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Ilir PANDA**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 02.07.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 220 Akti, datë 17.06.2020, si më poshtë:

Kërkues: **Bashkia Tiranë**

Objekti: Pezullimi i ekzekutimit të Vendimit nr. 3229 (80-2016-3231), datë 22.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i lënë në fuqi me Vendimin nr. 107 (86-202-159), datë 29.01.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Znj. Anila Tugu**

I paditur: **Bashkia Tiranë**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjo i relativin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 3229 (80-2016-3231), datë 22.06.2016 ka vendosur ndër të tjera:

“- Pranimin e padisë.

– Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative në trajtën e urdhrit nr. 4312, datë 15.02.2016 “Për largimin nga shërbimi civil” të Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Vendimit “Për lirimin nga shërbimi civil” nr. 4433, datë 10.02.2016 të Drejtorisë së Planifikimit të Burimeve Njerëzore të Rekrutimit dhe Procedurave.

– Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të procedojë me nxjerrjen e aktit administrativ për transferimin e paditëses në një pozicion të barazvlefshëm me atë të mëparshëm apo më të ulët në shërbimin civil, si dhe të bëjë trajtimin financiar të paditëses me pagën e mëparshme, që nga data 15.02.2016 e deri në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi.”.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 107 (86-2020-159), datë 29.01.2020 ka vendosur:

“Lënien në fuqi të Vendimit nr. 3229, datë 22.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.

3. Kundër Vendimit nr. 107 (86-2020-159), datë 29.01.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i të dy vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. Me datë 15.06.2020 pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- Duke qenë se është ushtruar rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit dhe çështja është në pritje të gjykimit nga Gjykata e Lartë, duhet të vendoset pezullimi i ekzekutimit të vendimit;
- Bashkia Tiranë ka vepruar në përputhje me Ligjin nr. 152/2013 dhe me Vendimin nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave dhe me Ligjin nr. 139/2015, pasi ka dalë struktura e re organizative;
- Ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur dhe se për rrjedhojë duhet të pezullohet sepse dëmet që mund të vijnë janë të tilla që prekin buxhetin e institucionit dhe mirëfunksionimin e institucionit.

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i

subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar

nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se në këtë rast nuk ka asnjë argument apo provë që të vërtetojë shkaqe me të cilat ligji lejon zbatimin e masës së përkohshme procedurale sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile. Të njëjtat argumente që i përkasin rekursit janë parashtruar edhe në kërkesën për pezullim. Për rrjedhojë kërkesa është e pambështetur në prova dhe në ligj. Kërkesa të tilla nuk duhet të përsëriten më në të ardhmen, pasi përndryshe do të konsiderohen si abuzim me të drejtën e padisë.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Bashkisë Tiranë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 3229 (80-2016-3231), datë 22.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i lënë në fuqi me Vendimin nr. 107 (86-202-159), datë 29.01.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, me datë 02.07.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 217 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Irir PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 02.07.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 217 Regjistri Themeltar, datë 05.06.2020, si më poshtë:

KËRKUES: Ndërmarrja Meico

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 3723 (80-2016-3737), datë 14.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 446, datë 25.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit

BAZA LIGJORE: Neni 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile

PADITËSE: **Z. Besim Kruja
Znj. Gëzime Kruja (Veizaj)
Znj. Xhemaile Kruja (Meraj)
Z. Bashkim Kruja
Znj. Bajame Kruja (Tufa)
Znj. Bukuriye Kruja (Jonuzi)
Z. Çlirim Kruja
Znj. Adelina Kruja (Jonus)
Znj. Katerina Kruja (Tufa)**

I PADITUR: **Këshilli i Ministrave
Ministria e Mbrojtjes
Ndërmarrja Meico
Albademil sh.p.k.
Avokatura e Shtetit**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoj relativin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3723 (80-2016-3737), datë 14.07.2016** ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e kërkesëpadisë. – Detyrimin e palës së paditur solidarisht, ndërmarrja Meico dhe shoqëria Alba Demil sh.p.k., t’i shpërblejë paditësit vlerën e dëmit jo pasuror në shumën totale 25.000.000 Lekë. – Shpenzimet gjyqësore të dokumentuara i ngarkohen palës së paditur.*”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 446, datë 25.02.2020** ka vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr. 3723, datë 14.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me këtë ndryshim: - Detyrimin e të paditurve solidarisht t’i shpërblejë paditësit vlerën e dëmit jopasuror në shumën totale 25.000.000 Lekë.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 446, datë 25.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Ndërmarrja MEICO. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj. Rekursi është pranuar për gjykim nga gjykata e shkallës së parë.

4. **Me datë 22.05.2019 Ndërmarrja MEICO ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi penal i formës së prerë ka vendosur se përgjegjësi ka pasur shoqëria Albademil sh.p.k. dhe shoqëria amerikane SAC, që me kontratë kanë marrë përsipër ushtrimin e aktivitetit në siguri maksimale;*
- *Ndërmarrja MEICO nuk mundet të mbajë përgjegjësi pse ka shitur mallin ushtarak për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes tek shoqëritë demontuese;*
- *Përgjegjësia e MEICO mbaron kur lidhet kontrata e shitjes dhe dorëzohet malli i blerë dhe ka kryer të gjitha veprimet sipas objektit të veprimtarisë së saj duke respektuar ligjin;*
- *Gjykata në kundërshtim me ligjin nuk ka marrë parasysh prapsimin e parashkrimit shues të padisë, sipas nenit 112, 115, 117, 120 të Kodit Civil;*
- *Akti i ekspertimit ka të meta dhe nuk është i bazuar në prova;*
- *Ekzekutimi i vendimit titull ekzekutiv ka nisur dhe vlera e përgjithshme e detyrimeve që ai përfaqëson është shumë e madhe dhe se aktualisht ndërmarrja nuk ka mundësi të shlyejë detyrimin;*
- *Ekzekutimi i vendimit do të shkaktonte dëme të pakthyeshme për shoqërinë, pasi ndërmarrja është organizuar me vetëfinancim dhe nuk mbulohet nga buxheti i shtetit;*
- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja.*

5. Rezulton se ka nisur procedura e ekzekutimit të detyrueshëm nga ana e shërbimit përmbartimor gjyqësor privat. Gjykata e Lartë ka proceduar me njoftimin e kërkesës për pezullim tek palët ndërgjyqëse.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për

pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk ka paraqitur argumentet dhe provat konkrete për vërtetimin e dëmit të riparueshëm dhe të atëçastshëm që palës debitore mund t'i vijë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së ndërmarrjes MEICO për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 3723 (80-2016-3737), datë 14.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi dhe ndryshuar me Vendimin nr. 446, datë 25.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 02.07.2020

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 221 I Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Iilir PANDA**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 02.07.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 221 Akti, datë 17.06.2020, si më poshtë:

Kërkues: **Znj. Marjana Cara**

Objekti: Pezullimi i ekzekutimit të Vendimit nr. 4280, datë 06.12.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Znj. Marjana Cara**

I paditur: **Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 928, datë 10.03.2014** ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e pjesshëm të padisë. – Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të titujve ekzekutiv, vendimit për vënie gjobe nr. 20, datë 01.02.2012 dhe vendimit për vënie gjobe nr. 32, datë 01.02.2012 të Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar. – Rrëzimin e padisë për sa i përket kërkimeve të tjera. – Ligjërimin e pezullimit të*

ekzekutimit të vendimit nr. 20, datë 01.02.2012 dhe vendimit për vënie gjobe nr. 32, datë 01.02.2012 të Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar.”.

Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë gjykata ka pranuar kërkesën e palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit administrativ objekt padie derisa të zgjidhet çështja. Në përfundim të gjykimit është urdhëruar ligjërimi i masës së sigurimit të padisë.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 4280, datë 06.12.2016 ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 928, datë 10.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. – Rrëzimin e padisë së paditëses, Marjana Cara, si të pabazuar në ligj. – Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 4280, datë 06.12.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala paditëse. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

4. Me datë 17.06.2020 pala paditëse, znj. Marjana Cara, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të përfundojë shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë;*
- *Ka dy vendimmarrje krejtësisht të ndryshme nga dy gjykatat e faktit;*
- *Duke pasur parasysh jurisprudencën “Rrapo v. Shqipërisë” dhe “Xheraj v. Shqipërisë” dhe nenin 14 pika 5 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike duhet që të mos ekzekutohet një vendim i cili nuk ka statusin e vendimit gjë të gjykuar.*

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të

pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë vlerëson se fakti se ligji procedural civil dhe administrativ lejon ushtrimin e rekursit ndaj vendit të gjykatës së apelit, i cili sipas nenit 451 shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Civile, është i formës së prerë dhe për rrjedhojë drejtpërdrejtë i ekzekutueshëm, nuk është një argument se gjithmonë ushtrimi i rekursit duhet të passjellë edhe pezullimin e vendimit gjyqësor të ankimuar meqë ligjërisht nuk ka fituar statusin ligjor të vendimit gjyqësor gjë të gjykuar. Për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ky pretendim i palës paditëse dhe njëkohësisht kërkuese është i pabazuar në ligj.

14. Kolegji vlerëson se fakti që ka dy vendimmarrje të ndryshme nga gjykatat e faktit nuk passjell automatikisht pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit ndaj të cilit është ushtruar rekurs. Sigurisht kjo është një e dhënë që kërkon vëmendje të posaçme nga ana e Gjykatës së Lartë por që gjithsesi kushtet dhe kriteret e zbatimit të masës së përkohshme procedurale duhet të ekzistojnë sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë edhe ky pretendim i kërkuesit vlerësohet të jetë i pabazuar në ligj.

15. Nga ana tjetër Kolegji sjell në vëmendje se në rastin konkret vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, që ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke rrëzuar padinë si të pabazuar në ligj, nuk është titull ekzekutiv sipas nenit 510 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile. Titulli ekzekutiv që po ekzekutohet në këtë rast është vendimi i gjobës së palës së paditur. Për rrjedhojë masat e përkohshme ndaj titullit ekzekutiv të ndryshëm nga vendimi gjyqësor i formës së prerë sipas nenit 510 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të jenë objekt i fushës së zbatimit të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile. Ky Kod ka parashikuar mjete juridike të zakonshme dhe të përkohshme mbrojtje për palët gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm dhe se Gjykata e Lartë në këtë fazë të procesit civil nuk mund të kërkohet të ushtrojë juridiksion fillestar por ekskluzivisht rishikues, sipas nenit 141 të Kushtetutës. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së znj. Marjana Cara për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 928, datë 10.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i ndryshuar me Vendimit nr. 4280, datë 06.12.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, me datë 02.07.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 225 I Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Irir PANDA**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 02.07.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 225 Prot., datë 24.06.2020, si më poshtë:

Kërkues: Avokatura e Shtetit

Objekti: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 23, datë 13.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit, që i përket çështjes nr. 188 Regjistri Themeltar.

Baza ligjore: Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: Z. Nuriye Topi
Znj. Drita Prence (Tirana)
Znj. Sofije Mhemetaj (Myrtaj)
Znj. Heroina Bega (Tirana)

I paditur: Agjencia e Trajtimit të Pronave

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. Sokol Sadushi, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 23, datë 13.02.2020 ka vendosur:

“- Pranimin e pjesshëm të padisë.

– Shfuqizimin e vlerësimit financiar të bërë nga pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave lidhur me vlerën e kompensimit për sipërfaqen prej 7011 m², për të cilën paditësve i u është njohur e drejta e kompensimit me Vendimin nr. 6/2, datë 28.08.1998 të ish-KKK Pronave Lezhë dhe detyrimin e palës së paditur të bëjë rivlerësimin financiar të kësaj sipërfaqe toke, me çmimin që i korrespondon zërit kadastral “truall”, sipas çmimit të hartës së vlerës së publikuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2016 për llojin e tokës truall, duke iu referuar çmimit të zonës kadastrale ku ndodhet prona.

– Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.”.

2. Pala e paditur nëpërmjet Avokaturës së Shtetit ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe rrëzimi i padisë.

3. Në aktin e rekursit pala e paditur, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe pritet të vendosë Gjykata e Lartë;
- Ekziston domosdoshmëria e marrjes së masës së pezullimit, pasi ka urgjencë dhe se ngarkimi i palës së paditur me këtë detyrim financiar do të rrezikonte funksionimin e institucionit;
- Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, premisën e parë të bazueshmërisë në ligj ka objektin, që do të thotë

vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret objekti i kërkesës nuk rezultoi të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë.

13. **Së pari**, sipas nenit 451 shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Civile parashikon se:
“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:
...ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”.

14. Në rastin konkret Gjykata Administrative e Apelit, sipas nenit 29 të Ligjit nr. 133/2015, e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar juridiksion fillestar.

15. **Së dyti**, sipas nenit 5 pika 17 e Ligjit nr. 133/2015 “Vendim përfundimtar” është çdo vendim administrativ ose gjyqësor, i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtuar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Më tej neni 30 i Ligjit nr. 133/2015 parashikon se:

“1. Kur vendimi i marrë, sipas këtij ligji, bëhet përfundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim.

2. Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të formës e prerë.”

16. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor objekt rekursi në këtë rast nuk është i formës së prerë. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet për gjykim. Përsëritja nga ana e kërkuarit e një kërkesë të tillë në të ardhmen do të përbëjë shkak ligjor për zbatimin e sanksionit procedural të parashikuar nga pika 1 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Avokaturës së Shtetit për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 23, datë 13.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 02.07.2020

ANËTAR
ILIR PANDA

ANËTAR
ERVIN PUPE

KRYESUES
SOKOL SADUSHI